



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:054146

Datë: 05.09.2019

Numri i dokumentit: 00495269

P. nr. 82/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.V. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188par1, nen.par. 1.4 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/IL.nr.1318/18 të datës 29.01.2019, në shqyrtimin e dytë gjyqësor **29.08.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, mbrojtësit të akuzuarit av. I.O. si dhe të akuzuarit M.V., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M.V.**, nga Gjakova, i biri Z. dhe i nënës A. e gjinisë B., data e lindjes..., ka të kryer shkollimin universitar, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- me datë 03.07.2018, rreth orës **14:00 min**, në Gjakovë, përballë restaurant “E.”, i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit B.Zh., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në furrë, aty kishte hyrë i ati i të pandehurit Z.V., të cilët dalin së bashku jashtë furrës, në atë moment jashtë furrës në veturë ishte i pandehuri M.V., i cili menjëherë është ofruar të dëmtuarit dhe ka filluar ta godas me grusht dhe shkelma në trup duke e rrëzuar në tokë, me çka i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruar hollësisht në akt ekspertizën mjeko – ligjore nga Dr.N.V., të datës 01.10.2018.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-ës .

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,41,43,46,73 , nenit 188 par.1-1.4 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton;

DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **400 (katërqind) euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **20 (njëzet) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,00 €(njëzetë) euro**.

I dëmtuari B.Zh. nga Gjakova, për të realizuar kërkesën e vet pasurore -juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet që i akuzuari ti paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej **20.00 euro** në emër të ekspertizën mjeko – ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20.00 euro**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP/II.nr.1318/18 të datës 29.01.2019, kundër të akuzuarit M.V. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1nën.par.1.4 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 18.07.2019, Prokurori i shtetit Enis Gashi lexojë aktakuzën PP/II.nr.1318/18 të datës 29.01.2019dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari M.V. duke u deklaruar lidhur me fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar ka theksuar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.I.O., ka parashtruar parashtrësë me datë 16.08.2019, me kërkesë për hüdhe të aktakuzës me arsyetimin se vepra penale për të cilën pandehet i akuzuari nuk përmban asnjë element të veprës penale që i njëjti ka kryer, e po ashtu provat të cilat i ka paraqitur në aktakuzë nuk e argumentojnë faktin se i njëjti e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.I.O., gjatë shqyrtimi të dytë gjyqësor, të mbajtur me dt. 29.08.2019, deklaroi se meqë kemi biseduar me të pandehurin M.V., kemi bërë analizimin e shkresave të lëndës, kemi interes juridik që kjo çështje penale të përfundojë, në një afat sa më të shkurtë, kemi ardhur në përfundim se i pandehuri pa ndikimin asnjë faktori të dhunës, mashtrimit apo cilido faktor tjetër, do ta pranojë fajësinë, lidhur me veprën penale për të cilën pandehet sipas aktakuzës.

I akuzuari M.V., deklaroi se në këtë fazë të procedurës pas konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin av.I.O., e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se deri te kryerja e kësaj vepre penale ka ardhur në afekt meqenëse vazhdimisht nga ana e të dëmtuarit dhe vëllezërve të tij jam i provokuar, jo vetëm unë por edhe anëtarët e tjerë të familjes, meqenëse nga ana e tyre dhe prindit tim në këtë gjykatë zhvillohet një procedurë kontestimore. Me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt, premtojë se një

veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, pendimin e shpreh në gjykatë për veprën e kryer, premtimin se një veprimi i tillë nuk do të përsëritet si dhe faktin se nuk kam qenë më parë i dënuar, andaj i propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë, si dhe faktin se asnjëherë nuk kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Armend Zenelaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit M.V., pasi që i njëjti pranimi e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka mbështetje në provat dhe faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës andaj, i propozoj gjykatës se i akuzuari M.V. të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit, po ashtu i njëjti të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari M.V.: **me datë 03.07.2018**, rreth orës **14:00 min**, në Gjakovë, përballë restaurant “E.”, i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit B.Zh., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në furrë, aty kishte hyrë i ati i të pandehurit Z.V., të cilët dalin së bashku jashtë furrës, në atë moment jashtë furrës në veturë ishte i pandehuri M.V., i cili menjëherë është ofruar të dëmtuarit dhe ka filluar ta godas me grusht dhe shkelma në trup duke e rrëzuar në tokë, me çka i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruar hollësisht në akt ekspertizën mjeko – ligjore nga Dr.N.V., të datës 01.10.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari të cilin në shqyrtimin e dytë gjyqësor vullnetarisht e ka pranuar fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimin te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të veprës penale të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte në gjykim, premtimin se ne të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, pendimin e shprehur për veprën e kryer si dhe faktin se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar

sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se ky sanksion do të ndikoj tek e akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari..

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 82/19 më datë 29.08.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë.Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.